



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 13331/2 prot

Fier më 26.12. 2024

VENDIM

Nr. 145 Datë 23 / 12 / 2024

PËR MIRATIMIN E STUDIMIT TEKNIKO-EKONOMIK PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË FIER QË PREKET NGA NDËRTIMI I NËN STACIONIT TË HOXHARËS(NËN STACIONI DHE VENDOSJE SHTYLLE) DHE DHËNIA NË PËRDORIM PËR SHTRIMIN E LINJËS SË RE 220 KV DOPJO QARK FIER – HOXHARË ME PËRCJELLËS ACSR 490/65”

Këshillit të Bashkisë Fier , sot më datën 23.12.2024 I paraqitet për shqyrtim materiali nga ekzekutivi i Bashkisë Fier për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes prej 2.8369 ha që preket nga ndërtimi i nënstacionit të Hoxharës dhe vendosja e shtyllës si dhe dhënia në përdorim përshtirjen e linjës prej 0.137 km me afat kohor sipas grafikut të punimit (14 muaj).

Në zbatim të :

1. Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet“ neni 5.
2. Ligji nr.139/2015 datë 17.12.2015 “ PërVetëQeverisjen Vendore “ neni 27 pika 5.
3. VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 “ Për dhënie në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre” ,
4. Udhëzimin nr. 1 datë 9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” pika 22 dhe 23
5. VKM-së nr.559,datë29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimit dhe tarifave për dhënien nëshfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore” të ndryshuara, pika 13.3, Këshilli I Bashkisë ,

VENDOSI:

1. Miratimin e Studimit tekniko ekonomik për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes prej 2.8369 ha që preket nga ndërtimi I nënstacionit dhe dhënia në përdorim për shtrirjen e linjës prej 0.137 km me afat kohor sipas grafikut të punimit (14 muaj)
2. Për vazhdimin e mëtejshme të procedurave administrativo – ligjore me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe subjektin OST ngarkohen Drejtoria e Çështjeve Bujqësore,Pyjeve,MjedistdheVeterinarisë pranë Bashkisë Fier .
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I KËSHILLIT
ANTONETA ÇUNAJ**

